

## AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### Es & Co Fashion Shpk

Ne Tirane, sot me date 10 Janar 2023 u mblohd Asamblea e Ortakut te Vetem te Shoqerise me prezencen e Ortakut te Vetem te saj znj.Esiona Llakmani, shtetase shoqiptare, e bija e Kocos, lindur ne Pogradec, me 17 Janar 1985, banuese Tirane, madhore me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I55117070W e cila me cilesine e "ortakut te vetem themelues" redaktoi kete Akt Themelimi, nepemjet te cilit deklaron se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin nr 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar me ligjin nr 129/2014 date 01.10.2014, ne ligjin nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", i ndryshuar me ligjin nr 131/2015 date 26.11.2015, ne legjislacionin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "**Es & Co Fashion**" shpk.

### KREU I

Neni 1  
Krijimi

1.1 Shoqeria, "**Es & Co Fashion**" shpk. eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2  
Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligjislacionin Shqiptar ne fuqi.

2.2 Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

2.3 Shoqeria "**Es & Co Fashion**" shpk., eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3  
Selia

3.1 Shoqeria e ka seline ne Tirane ne Adresen: Farke, Lunder, Njesia administrative Farke, Qendra Tregtare Tirana Eas Gate,(TEG) kat 1.

3.2 Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4  
Kohezgjatja

4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 5  
Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "**Es & Co Fashion**" shpk. perfshin:

- 5.1 Tregti me Pakice i veshjeve per femra e meshkuj.
- 5.2 Import Export i veshjeve dhe konfeksioneve
- 5.3 Shoqeria per permbushjen e objektit te saj mund te ndermar te tjera operacionet tregtare, industriale gjithashtu mund te realizoje ne rruge jo dominuese me te tere aksesoret dhe instrumentet, me perjashtim te disa aktivitetave te vena perballle publikut, dhe te siguroje garanci edhe ne favor te personave te trete, pervecse marrje persiper te investimeve te qendrueshme dhe jo pjesmarrje qofte direkt apo indirekt ne shoqerite jashte vendit, me nje objekt analog.

KREU II  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 ( njeqinde mijë) lekë, i ndare në 1 ( nje) pjesë, vlera nominale e të cilit eshte 100 000 lekë.
- 6.2 Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyet tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqerise "**Es & Co Fashion**" shpk, nepermjet transferes bankare, kuota me vlerë te per gjithshme 100 000 lekë, qe perbejne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 6.3 Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.
- 6.4 Ortaku i vetem per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;


Neni 7  
Transferimi i kapitalit

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut te Vetem.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve nepermjet akteve ligjore.

KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8  
Organi Vendimmarres

- 8.1 Asamblea e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2 Asamblea e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.
- 8.3 Asamblea e Ortakut te Vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton reportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,
- 8.4 Asamblea e Ortakut te Vetem mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.



Neni 9  
Ndryshimet e Statutit

9.1 Ndryshimet e statutit vendosen nga Asamblea e Ortakut te Vetem.

9.2 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10  
Administrimi

10.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblea e Ortakut te Vetem te shoqerise.

10.2 Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

10.3 Administratori/ret, mund te jete ose jo ortake.

10.4 Administratori/ret mund te shkarkohet ne cdo kohe.

10.5 Shoqeria do te funksionoj me nivel nje Administratori

10.6 Administrator te shoqerise eshte:

10.6.a znj.Esiona Llakmani, shtetase shqiptare, e bija e Kocos, lindur ne Pogradec, me 17 Janar 1985, banues ne Tirane, madhore me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet dokumentit te identifikimit me nr personal I55117070W.

10.7 Administratori i shoqerise do te ushtrojne komptencat e tij ne kete detyre per nje periudhe 5 ( pese) vjecare.

Neni 11  
Kompetencat

11.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka tё drejte tё kryeje tё gjitha veprimet e administrimit tё zakonshëm e tё jashtëzakonshëm.

11.2 Administratori pёrfaqësone Shoqerinë pёrpara tё gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tё huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo tё huaja, pёrfshi këtu autoritetet gjyqësore tё gjitha shkallevet.

11.3 Administratori ka tё gjitha kompetencat pёr tё vepruar nё marrëdhënie me tё tretët nё emër tё shoqërisë, nё tё gjitha rr Ethanat me pёrjashtim tё kompetencave qё ligji ia jep shprehimisht Ortakut te Vetem te Shoqerise.

11.4 Administratori angazhon shoqerinë nё marrëdhënet me tё tretët nёpërmjet akteve qё janë nё pёrputhje me objektin e veprimtarise se saj.

11.5 Administratori ka gjithashtu tё drejte tё nёnshkruajne kontrata tё ndryshme nё emër e pёr llogari te Shoqërisë, pёrfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit tё pasurive tё paluajtshme, operacione financiare, tё nёnshkruajne aktet e themelimit tё shoqërive tё tjera ku Shoqeria eshtë ortak, tё nёnshkruajne e hartojo ne çdo dokument e tё kryejne nё emër tё Shoqërisë çdo veprim pёrballe tё gjitha Bankave shqiptare apo te huaja nё lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse te Shoqërisë, nёnshkrimin e kontratave te ndryshme bankare pёr financimin e Shoqërisë si dhe te kryejnee veprime tёrheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

11.6 Shoqeria nuk merr pёrsipёr pasojat ndaj tё tretëve kur ajo provon se tё tretët e dinin qё akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur tё tretët nuk mund ta injoronin këtë akt nё rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk eshtë provë e mjaftueshme.



11.7 Klauzolat e ketij Akt Themelimi që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

11.8 Administratori ose Ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të jasin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12  
Viti Financiar

12.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

12.2 Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 13  
Shperndarje, Likujdimi ose Prishja e Shoqerise

13.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene :

13.2.a Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

13.2.b Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

13.2.c Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

13.3 Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1( nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14  
Baza Ligjore

14.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

14.2 Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15  
Dispozita perfundimtare

15.1 Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemclare me permnjte dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues i shoqerise tregtare "**F.R.Construzion**" shpk., nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të cilit vertetohet nga dokumenti i identifikimit katu bashkengjitur.

ORTAKU I VETEM

